Milaim Zeka

Thu 6 Feb

Messages and calls are end-to-end encrypted. Only people in this chat can read, listen to, or share them. **Click to learn more.**

Milaim Zeka uses a default timer for disappearing messages in new chats. New messages will disappear from this chat 90 days after they're sent, except when kept. Tap to set your own default timer.

Përshëndetje zt. Zeka,

Unë jam Vudi Xhymshiti, gazetar dhe fotoreporter hulumtues Britanik nga Londra, i fokusuar në tensione politike, konflikte të armatosura the hulumtime të profilit të lartë lidhur me çështje të sigurisë kombëtare.

Do të vlerësoja shumë nëse do të kishe mundësi të flisnim në një kohë të përshtatshme për ju lidhur me interesimin tim mbi diplomatin amerikan Richard Grenell.

Për më shumë rreth meje, ju lutem konsiderojeni këtë faqe: https://www.revistaspot.net/p/themuesi-i-spotlight

Pres përgjigjen tuaj.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti

Read more 21:15

A munde te flasim neser 22:50

Po, vetëm më thuaj të lutem në çfarë kohe afërsisht? 23:33

Fri 7 Feb

zt Zeka, jeni dakord qe t'ju telefonoj? 15:37

Voice call
25 sec
15:37

Voice call
27 min
15:41

Sun 9 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Duke reflektuar mbi bisedën tonë dhe veçanërisht mbi përfundimin e saj të premten, ku ju shprehët dyshime mbi kapacitetin tim në këtë çështje, dua ta sqaroj edhe një herë se, siç jua bëra të ditur në mesazhin e dërguar të enjten, unë jam gazetar hulumtues, ju mund ta verifikoni atë duke klikuar në vegëzën në vazhdim: https://www.thegpc.uk/about

Qëllimi im ishte dhe mbetet që të flas me ju mbi disa çështje të rëndësishme që lidhen me deklaratat tuaja publike për hetimet e Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë dhe pohimet tuaja mbi dyshimet për përfshirjen e prokurorit Jack Smith në një skandal të mundshëm korrupsioni.

Unë, bashkë me kolegë gazetarë amerikanë dhe britanikë, jemi duke i analizuar në thellësi këto pretendime. Duke qenë se ju keni qenë një nga zërat më të spikatur në diskursin publik shqiptar për këtë çështje, duke artikuluar akuza mbi përfshirjen e Jack Smith në një skandal korrupsioni, dua të nënvizoj edhe një herë se unë e bëra shumë të qartë qëllimin tim që në mesazhin e parë.

Pritshmëria ime ishte që të diskutoja me ju mbi pyetjet e rëndësishme lidhur me këto çështje, dokumentet që ju keni përmendur, si dhe pretendimet që keni bërë publikisht në emisione televizive. Ju keni deklaruar se keni zhvilluar hetime në kuadër të gazetarisë, por deri tani nuk ka ndonjë publikim gazetaresk mbi këto gjetje. Përkundrazi, sipas asaj që më thatë javën e kaluar, ju keni dorëzuar raportet tuaja në Departamentin e Shtetit të SHBA-së.

Hetimet tona mbi këtë çështje vazhdojnë, por qëllimi i këtij mesazhi është vetëm për të sqaruar edhe një herë se unë nuk kam asnjë kapacitet tjetër, asnjë përgjegjësi tjetër, asnjë autoritet tjetër përveçse atë të një gazetari hulumtues. Unë jam dhe mbetem gazetar investigativ, dhe ne po e hulumtojmë këtë çështje në emër të 'Gunpowder Chronicles' - thegpc.uk, një platformë dhe revistë investiguese me qendër në Londër, e cila merret me hetimin e çështjeve ndërkombëtare që lidhen me tensione politike, krimin e organizuar në politikë dhe konfliktet e armatosura.

Ju falënderoj për kohën tuaj dhe shpresoj në një bashkëpunim të hapur dhe profesional në të ardhmen, për të sqaruar çështjen që po i hetojmë.

Dua ta bëj edhe një herë të qartë se ju jeni subjekt i një procesi hulumtues gazetaresk, me qëllim kuptimin e motiveve dhe provave që mbështesin deklaratat tuaja publike.

Faleminderit për mirëkuptim dhe presim bashkëpunim nga ana e juaj.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti

Edited 20:44

Wed 12 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Shpresoj të jeni mirë. A do të ishit i gatshëm për një telefonatë të Enjten (nesër) më 13 Shkurt, 2025 në orën 10:00 sipas kohës së Londrës (11:00 në Prishtinë)?

Dua të diskutoj me ju disa detaje lidhur me pretendimet publike dhe raportimet mbi të ashtuquajturin "Agjent i rremë i CIA-s" dhe personin e njohur si Faik Ymeri. Gjithashtu, dua të qartësoj disa nga deklaratat tuaja mbi institucionet e drejtësisë në Evropë, përfshirë Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Referuar dokumentit "Finalized Complaint", në të cilin emri juaj përmendet, ky dokument përmban pretendime dhe detaje të rëndësishme mbi çështje që lidhen me mashtrime, keqpërdorim të pozitave dhe individë që kanë operuar nën identitete të dyshimta. Duke qenë se ju keni dhënë deklarata publike dhe keni përmendur raporte të dorëzuara në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, është e rëndësishme të adresojmë disa nga këto pretendime në mënyrë të saktë dhe të dokumentuar.

Ky hetim po zhvillohet nga Gunpowder Chronicles, një platformë gazetareske që analizon çështje të tensioneve politike, krimit të organizuar dhe korrupsionit në sferën ndërkombëtare. Si pjesë e kësaj analize, do të dëshiroja të kuptoja më mirë perspektivën tuaj mbi këto çështje dhe materialet që keni përmendur publikisht.

Lutem më njoftoni nëse ky orar ju përshtatet.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
Gunpowder Chronicles

21:32

Thu 13 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Vërejta që e keni lexuar mesazhin tim, por nuk mora një përgjigje.

A jeni i disponueshëm sot në orën 13:00 sipas kohës së Londrës (14:00 në Prishtinë) për një telefonatë?

Nëse ky orar nuk ju përshtatet, ju lutem propozoni një kohë që funksionon për ju.

Pres përgjigjen tuaj.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti

11:29

Nuk kam se çka me thane e as çka me shtu perpos asaj qe eshte shkruar ne raport, edhe ato qe i kam thene publikisht neper media

11:31

Milaim Zeka

Nuk kam se çka me thane e as çka me shtu perpos asaj qe eshte shkruar ne raport, edhe ato qe i kam thene publikisht neper media 11:31

Përshëndetje z. Zeka,

E kuptoj që keni shprehur qëndrimin tuaj në raport dhe në deklaratat publike. Megjithatë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të këtyre materialeve, në kombinim me hulumtimin tonë të mëtejshëm dhe informacionet e siguruara nga burimet tona në Londër, kemi arsye të besojmë se situata mund të mos jetë plotësisht ashtu siç është prezantuar deri më tani.

Për më tepër, burimet tona kanë sjellë në vëmendje disa detaje që sugjerojnë një perspektivë të ndryshme mbi rolin dhe përfshirjen tuaj të mundshme në këtë çështje. Duke qenë se jeni një zë kyç në këtë histori, do të ishte në interesin tuaj të keni mundësinë të adresoni këto çështje dhe të sqaroni pozicionin tuaj.

Prandaj, do të ishte e dobishme që të kemi një bisedë për të kuptuar më mirë perspektivën tuaj dhe për të siguruar që çdo interpretim i fakteve të jetë sa më i saktë dhe i drejtë. A do të ishit i disponueshëm për një telefonatë sot në orën 13:00 sipas kohës së Londrës (14:00 në Prishtinë), ose në një orar që ju përshtatet?

Me respekt,
Vudi Xhymshiti 11:41

Te thash jo 11:50

Përshëndetje z. Zeka,

Ne e marrim parasyshë përgjigjen tuaj. Megjithatë, duhet t'ju njoftoj se informacionet e konfirmuara dhe të verifikuara nga burimet tona sugjerojnë se mund të mos keni qenë plotësisht i saktë në deklaratat tuaja publike dhe pretendimet e bëra, përfshirë ato gjatë bisedës sonë të fundit telefonike.

Këto gjetje dalin si rezultat i verifikimeve të shumanshme që kemi kryer mbi deklaratat dhe raportimet tuaja.

Për këtë arsye, mendoj se do të ishte në interesin tuaj të adresoni këto çështje, pasi një bisedë me ne ju jep mundësinë të shpjegoni dhe të sqaroni ato që duken si mospërputhje apo pasaktësi. Nëse ndryshoni mendje dhe dëshironi të komentoni mbi këto zhvillime, mund të më njoftoni në çdo kohë.

Përndryshe, ne do të vazhdojmë me hulumtimin tonë duke u mbështetur në provat dhe burimet që kemi në dispozicion.

Read more 11:56

Po nuk ka asnje problem qe ju te vazhdoni dhe te beni punen tuaje, ne baze te burimeve tuaja 11:58

Përshëndetje z. Zeka,

Përpara se të ecim më tej me raportimin tonë, po ju informojmë se mund t'ju japim një mundësi për të shprehur qëndrimin tuaj në një fazë të mëvonshme të hetimit tonë.

Kjo mbetet një çështje serioze, pasi provat tona sugjerojnë se mund të keni qenë i përfshirë në përpjekje për të penguar institucionet ndërkombëtare të drejtësisë në punën e tyre. Për këtë arsye, do të ishte në interesin tuaj dhe të publikut që të jepni sqarime.

Nëse vendosni të mos komentoni tani, hulumtimi ynë do të vazhdojë bazuar në provat dhe verifikimet tona, por mbetet e hapur mundësia që të kemi një diskutim në një fazë të mëvonshme.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti 12:05

Cilat institucione nderkombetare? 12:06

Përshëndetje z. Zeka,

Për fat të keq, nuk mund t'ju përgjigjemi kësaj pyetjeje për shkak të mbrojtjes së subjektit në këtë çështje.

Jemi të gatshëm të diskutojmë me ju në një telefonatë, por tashmë nuk mund t'ju ofrojmë më mundësinë për një bisedë sot, për shkak të angazhimeve tona në hulumtime të tjera.

Megjithatë, jemi më se të gatshëm të zhvillojmë një bisedë javën e ardhshme dhe jemi të hapur për një orar që ju përshtatet. Na njoftoni me një propozim për kohën që preferoni.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
12:13

Vetem suksese ne punen tuaje 12:15

👍

Thu 20 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Kam disa pyetje për ju në lidhje me takimet tuaja me Halit Sahitaj:

Kur folët me mua në telefon, mohuat që keni takuar ndonjëherë Halit Sahitaj. Megjithatë, ka prova që sugjerojnë se jeni takuar me të në Kosovë midis 2016 dhe 2019, si dhe disa herë në Spanjë midis 2022 dhe 2024.
A mund të komentoni mbi këtë?

Thuhet se gjatë takimit të parë në Kosovë, ju i keni kërkuar Sahitajt të financojë krijimin e një televizioni dhe më pas keni kërkuar ndihmë për të blerë pajisje transmetimi, përfshirë kamera me vlerë €12,000.
A është kjo e vërtetë?

Në vitin 2022, ju dhe Halit Sahitaj dyshohet se jeni bashkuar për të fabrikuar një akuzë kundër Gjykatës Speciale të Republikës së Kosovës me seli në Hagë.
A mund ta komentoni këtë?

Në një raport të KLAN Kosova: https://youtu.be/xxgh2Up29jo - thuhet se dy dëshmitarë të Prokurorisë së Specializuar në Hagë janë hequr nga lista e dëshmitarëve të ZPS-së, pasi besohet se kanë ndryshuar qëndrimin dhe deklaratat e tyre.
Mbrojtja ka sugjeruar që Prokuroria t'i marrë këta dy dëshmitarë, por kjo e fundit ka refuzuar dhe ka sugjeruar që, nëse dëshiron, mbrojtja mund t'i thërrasë vetë.
A jeni ju dhe Halit Sahitaj këta dëshmitarë që Prokuroria i ka refuzuar dhe i ka rekomanduar mbrojtjes për t'i thirrur ata?

Nëse dëshironi, mund të flasim në një telefonatë për këtë çështje, të nesërmen ditë e Premte, 21 Shkurt, 2025, në orën 10/mëngjes kohë e Londrës.

Ju lutem më njoftoni nëse jeni i disponueshëm.

Faleminderit.
Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues
Gunpowder Chronicles
https://www.thegpc.uk/
22:23

Milaim Zeka

Fri 21 Feb

Përshëndetje zt Zeka,

Do ta vlerësoja shumë nëse mund të më ndaje një kontakt të Edlira Çefalija, të cilën në bisedën tonë të mëparshme telefonike e përmendët si kolege gazetare që po punonte për të hetuar akuzat ndaj ish-prokurorit të ZPS-së, Jack Smith, dhe një zotërie të quajtur Faik Imeri.

Gjithashtu, do ta vlerësoja jashtëzakonisht nëse ke ndonjë formë kontakti apo komunikimi për zotërinë Faik Imeri që mund të ndash me mua, pasi po has vështirësi për ta gjetur këtë person.

Faleminderit shumë për ndihmën!

Të përshëndes,
Vudi Xhymshiti

13:17

Sun 23 Feb

Të përshëndes,
Vudi Xhymshiti

13:17

Sun 23 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Ne në Gunpowder Chronicles kemi analizuar dokumentin e John F. Moynihan dhe dëshminë tuaj në lidhje me Gjykatën Speciale dhe rolin e Faik Imerit. Në këtë kontekst, kemi disa pyetje për ju dhe ju lutemi të ofroni sqarime dhe prova aty ku është e mundur:

1) Ju keni deklaruar se Faik Imeri ju është prezantuar si agjent i CIA-s dhe ka vepruar në emër të saj. A mund të ofroni prova konkrete që ai ka punuar për CIA-n apo ka vepruar në koordinim me prokurorët e Gjykatës Speciale?

2) Ju pohoni se keni zhvilluar një takim me ish-kryeprokurorin e Gjykatës Speciale, David Schwendiman, në Belgjikë. A mund të siguroni ndonjë provë që ky takim ka ndodhur, si p.sh. email-e, regjistrime telefonike, fotografi ose dëshmi nga persona të tjerë të pranishëm?

3) Në dëshminë tuaj përmendni një listë me 21 emra të përpiluar nga shërbimet sekrete suedeze me individë të mundshëm për t'u akuzuar nga Gjykata Speciale. A mund ta bëni publike këtë listë ose të siguroni prova të ekzistencës së saj?

4) Ju pretendoni se Faik Imeri ka përdorur emrin e Prokurorit Jack Smith për të kërkuar shuma të mëdha parash nga individë të ndryshëm në Kosovë. A dispononi ndonjë regjistrim audio ose shkresë që vërteton se ai e ka përmendur emrin e Prokurorit Smith në këtë kontekst?

5) Në dëshminë tuaj thuhet se ju keni paguar 320,000 euro për të shmangur një akuzë të fabrikuar nga Gjykata Speciale. A mund të siguroni dokumente bankare ose dëshmi të tjera që konfirmojnë këtë transaksion?
Kush ishte personi që i mori këto para?

6) Ju keni përmendur takime me ish-agjentin e FBI-së Charles McGonigal dhe Agron Nezën, të cilët dyshohet se kanë qenë të lidhur me skema korruptive. A mund të siguroni ndonjë provë për këto takime, si foto, mesazhe ose dëshmi të tjera?

7) Ju keni deklaruar se Faik Imeri ka qenë i përfshirë në vjedhjen e të dhënave nga telefoni i Kryeprokurorit të Kosovës, Aleksandër Lumezi, për qëllime shantazhi.
A keni ndonjë provë që mbështet këtë pretendim?

8) Në dëshminë tuaj përmendni se keni regjistrime audio të bisedave mes dëshmitarëve dhe prokurorëve të Hagës, ku përmendet drejtpërdrejt Jack Smith.
A mund t'i bëni publike këto regjistrime ose t'i dorëzoni ato si provë?

9) Ju përmendni një video ku pohoni se Faik Imeri pranon publikisht rolin e tij si ndërmjetës mes dëshmitarëve dhe Prokurorisë Speciale.
A mund të ofroni këtë video për analizë të mëtejshme?

A jeni të gatshëm të dëshmoni dhe të dorëzoni të gjitha provat në një hetim të pavarur ndërkombëtar për pretendimet tuaja?

Presim përgjigjen tuaj.

Faleminderit,
Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues
Gunpowder Chronicles
https://www.thegpc.uk

15:53 ✓

Përshëndetje z. Zeka,

Ne në Gunpowder Chronicles kemi analizuar dokumentin e John F. Moynihan dhe dëshminë tuaj në lidhje me Gjykatën Speciale dhe rolin e Faik Imerit. Në këtë kontekst, kemi disa pyetje për ju dhe ju lutemi të ofroni sqarime dhe prova aty ku është e mundur:

1) Ju keni deklaruar se Faik Imeri ju është prezantuar si agjent i CIA-s dhe ka vepruar në emër të saj. A mund të ofroni prova konkrete që ai ka punuar për CIA-n apo ka vepruar në koordinim me prokurorët e Gjykatës Speciale?

2) Ju pohoni se keni zhvilluar një takim me ish-kryeprokurorin e Gjykatës Speciale, David Schwendiman, në Belgjikë. A mund të siguroni ndonjë provë që ky takim ka ndodhur, si p.sh. email-e, regjistrime telefonike, fotografi ose dëshmi nga persona të tjerë të pranishëm?

3) Në dëshminë tuaj përmendni një listë me 21 emra të përpiluar nga shërbimet sekrete suedeze me individë të mundshëm për t'u akuzuar nga Gjykata Speciale. A mund ta bëni publike këtë listë ose të siguroni prova të ekzistencës së saj?

4) Ju pretendoni se Faik Imeri ka përdorur emrin e Prokurorit Jack Smith për të kërkuar shuma të mëdha parash nga individë të ndryshëm në Kosovë. A dispononi ndonjë regjistrim audio ose shkresë që vërteton se ai e ka përmendur emrin e Prokurorit Smith në këtë kontekst?

5) Në dëshminë tuaj thuhet se ju keni paguar 320,000 euro për të shmangur një akuzë të fabrikuar nga Gjykata Speciale. A mund të siguroni dokumente bankare ose dëshmi të tjera që konfirmojnë këtë transaksion?
Kush ishte personi që i mori këto para?

6) Ju keni përmendur takime me ish-agjentin e FBI-së Charles McGonigal dhe Agron Nezën, të cilët dyshohet se kanë qenë të lidhur me skema korruptive. A mund të siguroni ndonjë provë për këto takime, si foto, mesazhe ose dëshmi të tjera?

7) Ju keni deklaruar se Faik Imeri ka qenë i përfshirë në vjedhjen e të dhënave nga telefoni i Kryeprokurorit të Kosovës, Aleksandër Lumezi, për qëllime shantazhi.
A keni ndonjë provë që mbështet këtë pretendim?

8) Në dëshminë tuaj përmendni se keni regjistrime audio të bisedave mes dëshmitarëve dhe prokurorëve të Hagës, ku përmendet drejtpërdrejt Jack Smith.
A mund t'i bëni publike këto regjistrime ose t'i dorëzoni ato si provë?

9) Ju përmendni një video ku pohoni se Faik Imeri pranon publikisht rolin e tij si ndërmjetës mes dëshmitarëve dhe Prokurorisë Speciale.
A mund të ofroni këtë video për analizë të mëtejshme?

A jeni të gatshëm të dëshmoni dhe të dorëzoni të gjitha provat në një hetim të pavarur ndërkombëtar për pretendimet tuaja?

Presim përgjigjen tuaj.

Faleminderit,
Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues

MZ **Milaim Zeka**

Mon, 24 Feb

Përshëndetje z. Zeka,

Shpresoj të jeni mirë.

Dëshirojmë të sqarojmë se arsyeja pse kemi kërkuar të kontaktojmë me ju përmes platformës Signal është fakti që kemi vërejtur se nuk është më e mundur të komunikojmë përmes WhatsApp-it. Si gazetarë hulumtues, ne kemi detyrimin profesional të sigurojmë sqarime dhe prova mbi deklaratat publike që lidhen me çështje me interes të lartë publik, përfshirë ato të bëra nga ju.

Në këtë frymë, po ju ofrojmë mundësinë që të shprehni qëndrimin tuaj dhe të kontribuoni në sqarimin e këtyre çështjeve në mënyrë të drejtë dhe transparente. Megjithatë, duhet të theksojmë se nuk mund të ofrojmë një kohë të pakufizuar për këtë mundësi, pasi dritarja për të dhënë shpjegimet tuaja në kuadër të hetimit tonë po mbyllet së shpejti.

Presim përgjigjen tuaj sa më parë të jetë e mundur.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues
Gunpowder Chronicles
https://www.thegpc.uk

10:58

Sun, 9 Mar

Përshëndetje z. Zeka,

Jam Vudi Xhymshiti, gazetar hulumtues nga Gunpowder Chronicles. Gjatë hulumtimit tonë mbi bashkëpunimin mediatik, kemi zbuluar se ju keni shitur pamje filmike të periudhës së luftës në Kosovë te Radio Televizioni i Serbisë (RTS), përmes Sladana Zariç. A mund të na sqaroni konkretisht se çfarë materiali keni dorëzuar dhe a jeni në dijeni se për çfarë qëllimi janë përdorur këto pamje nga RTS?
Gjithashtu, a i keni menduar pasojat potenciale, duke përfshirë rrezikun që persona të identifikuar në këto materiale mund të ndiqen penalisht nga autoritetet serbe?

Ju faleminderit për mirëkuptimin,
Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues
Gunpowder Chronicles
https://www.thegpc.uk

17:41

MZ **Milaim Zeka**

- zt Zeka, gjithashtu, dua të ju tregoj se e km lexuar postimin tuaj (27/11/2024): https://www.facebook.com/profile/100010561562194/search/?q=rts - rreth bashkëpunimit me RTS-në dhe pagesës prej 1950 euro që ka kaluar përmes një llogarie bankare në Tiranë.

Për shkak të ndjeshmërisë së materialeve që mund të përmbajnë identitete të personave gjatë luftës, ju lutem të na ofroni prova konkrete lidhur me këtë transaksion, si dhe një përshkrim të qartë të pamjeve që keni dorëzuar te RTS. Është thelbësore të sigurohemi që këto pamje nuk kanë vënë në rrezik persona që mund të identifikohen dhe më pas të përballen me pasoja penale nga autoritetet serbe.

Ky informacion është jetik për transparencë dhe mbrojtjen e individëve që mund të jenë identifikuar padrejtësisht.

Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Vudi Xhymshiti
Gazetar Hulumtues
Gunpowder Chronicles
https://www.thegpc.uk

18:03

Message

Kërkesë për Koment mbi Gjetjet e Hulumtimit Tonë

Vudi Xhymshiti [redacted]
to Milaim

Tue 11 Mar, 12:24

I nderuar z. Zeka,

Po ju kontaktojmë përmes këtij emaili pasi kemi arsye të besojmë se keni zgjedhur të na bllokoni nga komunikimi nëpërmjet WhatsApp-it. Ndërsa e respektojmë këtë zgjedhje, parimet tona gazetareske na udhëzojnë t'ju ofrojmë edhe një mundësi për të shprehur qëndrimin tuaj mbi gjetjet tona investigative që lidhen me ju.

Gunpowder Chronicles ka zhvilluar një hulumtim të detajuar mbi veprimtarinë tuaj profesionale dhe lidhjet që keni krijuar me aktorë të ndryshëm në skenën politike dhe mediatike. Gjetjet tona përfshijnë një sërë akuzash dhe dyshimesh të bazuara në dokumente, dëshmi dhe burime të verifikuara, duke përfshirë:

- Rolin tuaj në manipulimin e dëshmitarëve në Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe lidhjet me Halit Sahitaj, Darko Perovic dhe bashkëshorten tuaj, znj. Edlira Çefalija.
- Përfshirjen tuaj në një skemë mashtrimi me viza, e cila ka dëmtuar qindra qytetarë kosovarë.
- Marrëdhënien tuaj me ish-Presidentin Hashim Thaçi dhe përpjekjet për të ndikuar në narrativën rreth Dhomave të Specializuara.
- Shitjen e arkivave tuaja të luftës te Radio Televizioni i Serbisë (RTS) dhe lidhjet e mundshme me qarqe të financuara nga shteti serb.
- Pretendimet për përfshirje në shantazh dhe përpjekjet për të përdorur median për përfitime financiare dhe ndikim politik.
- Lidhjet tuaja me Richard Grenell dhe përpjekjet për të ndikuar në narrativën rreth Tribunalit të Hagës.

Pavarësisht përpjekjeve tona të mëparshme për të marrë qëndrimin tuaj mbi këto çështje, nuk kemi marrë asnjë përgjigje të qartë nga ana juaj. Nëse dëshironi të komentoni ose të jepni versionin tuaj të fakteve, jemi të gatshëm të zhvillojmë një bisedë zyrtare në të cilën mund të shprehni qëndrimin tuaj mbi këto gjetje.

Ju lutemi të na njoftoni nëse jeni i gatshëm për një përgjigje zyrtare dhe një bisedë në regjistrim.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
Gunpowder Chronicles

--
Vudi Xhymshiti
London-based Photographer & Journalist
[redacted] | https://www.thegpc.uk/about — I specialise in reporting at the intersection of **race, gender, identity, migration,** and the **forces political, climatic, or military that displace people**. My conflict reporting spans the Arab Spring, the ongoing Russian aggression in Ukraine, the Armenian-Azerbaijani conflict, and the Balkans.

Thaçi dhe Gjykata Speciale

Inbox ×

Vudi Xhymshiti <[redacted]n>
to [redacted]a

21 Mar 2025, 17:11 (13 days ago)

I nderuar z. Zeka,

Po ju shkruajmë përsëri për t'ju kujtuar dhe për t'ju inkurajuar që të përgjigjeni në lidhje me emailin tonë të dërguar më 11 mars, 2025. Deri më tani nuk kemi marrë një përgjigje nga ana juaj, dhe duke marrë parasysh natyrën serioze të çështjeve të ngritura, do të ishte e rëndësishme që të dëgjonim qëndrimin tuaj.

Ndërkohë, kemi vërejtur se ju vazhdimisht sulmoni Dhomat e Specializuara të Hagës në mbështetje të ish-Presidentit Hashim Thaçi.

Gjetjet tona investigative sugjerojnë se keni dorëzuar mbi 30 kërkesa për ta vizituar atë, por ai gjithmonë ka refuzuar përpjekjet tuaja për një takim.

Pse mendoni se ai nuk ka pranuar t'ju takojë?

Siç e kemi theksuar më parë, qëllimi ynë është të japim hapësirën tuaj për të komentuar mbi gjetjet tona. Ju ftojmë përsëri të ofroni versionin tuaj të fakteve dhe të na kontaktoni për të caktuar një bisedë zyrtare në regjistrim.

Presim përgjigjen tuaj.

Me respekt,

Vudi Xhymshiti

Gunpowder Chronicles

milaim zeka
to me

21 Mar 2025, 18:17 (13 days ago)

Translate to English

Beso qe prej se kam lindur, kurr njeri ma lope se ty nuk kam pa. Jo 30, po nese nje kerkese e gjene qe e kam bere, une jap doreheqje nga jeta publike.

Mos me shkruaje kurr me, sepse ti vetem mundesh me qene nje njeri jo ne rregull menderisht!

Keto jane shantazhe, edhe une do te hap rast per shantazh edhe ne organet e drejtesise ne Kosove, po edhe ne Shqiperi

MSc. Milaim Zeka
Deputet i Parlamentit te Republikes se Kosoves
Member of Parliament os Kosovo Republic.
Mob: +377449[redacted]

Vudi Xhymshiti <vudi.[redacted]>
to milaim

21 Mar 2025, 18:41 (13 days ago)

I nderuar z. Zeka,

Faleminderit për përgjigjen tuaj.

Është për të ardhur keq që vendosët të reagonit në mënyrë emocionale dhe ofenduese në vend që të angazhoheni në një diskutim profesional dhe faktik mbi çështjet që i kemi ngritur.

Siç e kemi theksuar më parë, qëllimi ynë është të ofrojmë hapësirën për qëndrimin tuaj mbi gjetjet tona investigative. Kjo është një praktikë standarde gazetareske që siguron raportim të balancuar dhe të drejtë. Për fat të keq, nuk morëm ndonjë sqarim të qartë nga ana juaj mbi faktet konkrete që kemi paraqitur.

Lidhur me deklaratën tuaj për dorëheqje nga jeta publike nëse ekziston qoftë edhe një kërkesë e vetme që keni bërë për të takuar z. Hashim Thaçi, do të mirëprisnim një qartësim më të detajuar nëse dëshironi të sqarohet ky aspekt me dokumentacion përkatës.

Për sa i përket akuzës suaj për shantazh, dëshirojmë të theksojmë se **ofrimi i mundësisë për të komentuar mbi një hetim gazetaresk nuk përbën shantazh**. Përkundrazi, refuzimi për të ofruar një përgjigje ose angazhimi përmes kërcënimeve dhe fyerjeve nuk e ndryshon realitetin e fakteve që kemi mbledhur.

Gjithashtu, dëshirojmë t'ju rikujtojmë se **Gunpowder Chronicles —** https://www.thegpc.uk/about **— është subjekt i ligjeve dhe rregulloreve të Mbretërisë së Bashkuar dhe operon sipas standardeve ndërkombëtare të gazetarisë investigative**. Çdo pretendim ligjor duhet të trajtohet brenda kornizës së duhur juridike dhe në përputhje me parimet e lirisë së shtypit.

Ne mbetemi të hapur për një përgjigje zyrtare nga ana juaj, nëse vendosni të angazhoheni në një diskutim profesional dhe të bazuar në fakte.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
Gunpowder Chronicles

Pyetje urgjente në lidhje me pozicionin tuaj

Vudi Xhymshiti [redacted]
to Milaim

Sat 22 Mar, 09:42

I nderuar z. Zeka,

Po shkruajmë edhe një herë lidhur me emailet tona të mëparshme të datës **11 mars 2025** dhe **21 mars 2025**, për të cilat ende nuk kemi marrë një përgjigje të qartë nga ana juaj.

Si rikujtim, më parë ju kemi pyetur për komentet tuaja mbi gjetjet tona investigative në lidhje me përpjekjet tuaja të përsëritura për të vizituar ish-presidentin **Hashim Thaçi**, të cilat, sipas burimeve tona, janë refuzuar vazhdimisht nga ai. Ju e keni mohuar këtë duke deklaruar se nuk keni bërë asnjë kërkesë të tillë. Ne mbetemi të hapur për të pranuar çdo provë dokumentare nga ana juaj që mund të sqarojë këtë çështje.

Për më tepër, sipas gjetjeve tona të fundit, ju keni një lidhje të afërt me **Halit Sahitaj**, një figurë kyçe në raportin e betimit të **John F. Moynihan**, por nuk jeni më i mirëpritur nga rrethi i ngushtë i ish-presidentit Thaçi.

Burime brenda shërbimit sekret joformal të Kosovës **SHIK** na kanë informuar se, ndonëse pritej të ftoheshit si një dëshmitar kyç i mbrojtjes së Thaçit këtë prill – diçka që na është konfirmuar edhe nga **Halit Sahitaj** – tashmë nuk jeni të dëshiruar të konsideroheni si dëshmitar.

Pyetja jonë për ju është:

A e mohoni këtë pretendim nga burimi ynë, apo mund të konfirmoni vërtetësinë e tij?

Nëse jeni përjashtuar nga mbrojtja, **përse jeni përjashtuar**?

Dhe nëse thoni se kjo nuk është e vërtetë, **cili është verzioni i së vërtetës sipas dëshmisë tuaj, z. Zeka?**

Ne mbetemi në pritje të përgjigjes suaj dhe ju rikujtojmë se qëllimi ynë është të sigurojmë hapësirën për qëndrimin tuaj mbi këto çështje.

Me respekt,
Vudi Xhymshiti
Gunpowder Chronicles

--
Vudi Xhymshiti
London-based Photographer & Journalist
+44 [redacted] | https://www.thegpc.uk/about — I specialise in reporting at the intersection of **race, gender, identity, migration,** and the **forces political, climatic, or military that displace people**. My conflict reporting spans the Arab Spring, the ongoing Russian aggression in Ukraine, the Armenian-Azerbaijani conflict, and the Balkans.